



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI I LËNDËS
Të Nxënët dhe Menaxhim i Klasës

Ngarkesa: 3 kredite; 45 orë mësimore; 30 leksione / 15 seminare
Viti / Semestri : Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Mësuesi e gjuhës italiane”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike mbi modelet dhe teoritë kryesore të të nxënët, duke theksuar ndikimin e tyre në zhvillimin e mësimdhënies bashkëkohore. Të aftësojë studentët për të analizuar dhe përmirësuar modelet e të nxënët, duke marrë parasysh nevojat individuale të nxënësve dhe kontekstin postmodern arsimor.

Të nxisë reflektimin kritik mbi përvojat personale të të nxënët dhe ndërtimin e qasjeve të personalizuar për një të mësuar me nxënësin në qendër.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të dallojnë dhe analizojnë teoritë klasike dhe moderne të të nxënët, si dhe ndikimin e tyre në praktikën pedagogjike.
2. Të zhvillojnë aftësinë për të dizajnuar orë mësimore të integruara që mbështesin të nxënët aktiv, motivimin, zbulimin dhe autonominë e nxënësit.
3. Të aftësohen në përdorimin e strategjive të ndryshme si inteligjencat e shumfishta, pyetja efektive dhe përshtatja e objektivave sipas nevojave të nxënësve.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti identifikon, krahason dhe vlerëson teoritë dhe modelet kryesore të të nxënët, duke i lidhur me praktika konkrete mësimore.
2. Studenti harton dhe zbaton orë mësimore të personalizuar që përfshijnë strategji bashkëkohore dhe i përshtaten nevojave të ndryshme të nxënësve.
3. Studenti reflekton në mënyrë kritike mbi përvojat e veta mësimore dhe i përdor ato për të përmirësuar aftësitë profesionale në mësimdhënie.